



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 672/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi -Kryetar, Agon Ramadani Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Gurëbardhi" sh.p.k, me seli në Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me zhavorr për riparim të rrugëve lokale dhe fushore për shërbime tjera për pastrim të kanaleve nga inertet te lumenjve ne rruge dhe zona urbane" me nr. të prokurimit 634-22-9062-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me datën 05.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**1. Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik, "Gurëbardhi" sh.p.k, me seli në Klinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 17.10.2022 (me numër protokolli 672/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me zhavorr për riparim të rrugëve lokale dhe fushore për shërbime tjera për pastrim te kanaleve nga inertet të lumenjve ne rruge dhe zona urbane" me nr. të prokurimit 634-22-9062-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK).

**2. Mbetet ne fuqi** njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me zhavorr për riparim te rrugëve lokale dhe fushore për shërbime tjera për pastrim të kanaleve nga inertet te lumenjve ne rruge dhe zona urbane".

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për

mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

4. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A r s y e t i m**

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur, kontratë për punë, vlera e madhe, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës:300,000,00 €

Me 03.11.2022, Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 (Letër Standarde)për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me zhavorr për riparim te rrugëve lokale dhe fushore për shërbime tjera për pastrim te kanaleve nga inertet të lumenjve ne rruge dhe zona urbane” me nr. të prokurimit 634-22-9062-5-2-1.

Me datë 09.11.2022 Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e AK-së.

Me datën 15.11.2022 Operatori Ekonomik "Gurëbardhi"sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 672/2022, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorjë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 05.12.2022, ekspertet shqyrtues kanë dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

-ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar,

-mbetet në fuqi vendimi i AK-Komuna Klinë.

#### Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 672/22 ka të bëjë me arsyet e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së OE nuk ka plotësuar kërkesa për CV te inxh. Ndërtimtarisë, deklarata e ATK-se nuk i ka gjithë punëtorët e deklaruar, pajisjet ka marrëveshje me “Saba Belca” dega ne Kosovë makinerinë e ka në shfrytëzim “Saba Belca” dega Serbi, nuk ka ngarkues 20-30t, grider nuk ka te caktuar peshë specifike

Të gjitha këto arsyetime te AK konsiderojmë se kanë mund të sqarohen në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, ashtu siç pretendon edhe OE ankues.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Me gjithat AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim i ka shtuar edhe një arsye të eliminimit: ku sipas AK-së inxhinieri për emergjenca z.Driton Caka nuk arrin përvojën e punës të kërkuar prej vite pasi i njëjti ka diplomuar në 18.12.2019.

Vlerësimi jonë është që refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, pasi arsyeja kryesore për refuzim bazohet në diçka që nuk është kërkuar nga ankuesi,

Si do që të jetë duhet të sqarojmë se gjendemi para një gjendje faktike te cilën nuk mund ta mohojmë, ku z.Driton Caka përmes diplomës dëshmohet se vërtet ka diplomuar me 18.12.2019.

#### Pretendimi nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë është se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes pasi për Cilindër 27 ton ka ofruar dud doganor në të Cilin pesha e cilindrit është e shënuar me dorë, me laps.

Ne pajtohemi me konstatimet e OE ankues se pesha e cilindrit është e shënuar me dorë dhe e njëjta eventualisht mund të mos jetë e saktë.

Me gjithë këtë ne në mënyrë të pavarur kemi bërë hulumtime të mëtutjeshme dhe kemi gjetur pajisja/cilindri ' Hamm HDI 2 VV” e ka peshën 2.695kg, që sipas mendimit tonë është ekuivalente me 2.7ton. Provë : Linku me infot e pajisjes : <https://www.wirtgen-group.com/ocs/en-th/hamm/hd-12-vv-1830-p/> Bazuar ne këto ë u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

#### **Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të mbetet në fuqi vendimi i AK-KK Klinë.

Në këtë rast, duke i analizuar shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme dhe se administrimi i tyre dhe vendimi meritor lidhur me çështjen në rastin konkret, mund të merret dhe pa dëgjimin e palëve, sikurse parashihet kjo me dispozitën e nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli Shqyrtues, bazuar në shkresat e kësaj lënde, duke i krahasuar dhe analizuar të gjitha ato, veçoi në këtë rast gjetjet dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, përkitazi me hulumtimet e tij për secilin pretendim posaçërisht, siç prezantohen shkurtimisht në vijim këtij të arsyetimi.

PSH lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me arsyet e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së, OE nuk ka plotësuar kërkesa për CV te inxh. Ndërtimtarisë, deklarata e ATK-se nuk i ka gjithë punëtorët e deklaruar, pajisjet ka marrëveshje me “Saba Belca” dega ne Kosovë makinerinë e ka në shfrytëzim “Saba Belca” dega Serbi, nuk ka ngarkues 20-30t, grider nuk ka te caktuar peshë specifike, Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Ndërsa, sa i përket refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, njëherit duke shtuar edhe një arsye të eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së inxhinieri për emergjenca z.Driton Caka nuk arrin përvojën e punës të kërkuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prej 3 vite përvojë pune, konstatim ky të cilin e bënë edhe eksperti shqyrtues i prokurimit dhe paneli shqyrtues konsideron se, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, pasi arsyeja kryesore për refuzim bazohet në diçka që nuk është kërkuar nga ankuesi, megjithatë njëjtë sikur eksperti, PSH gjendet para një gjëndje faktike e cila ndryshon rrjedhën e shqyrtimit për arsye se vërteton faktin se OE ankues nuk e plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit sa i përket Inxhinierit të emergjencave dhe oferta si e tillë është e papërgjegjshme.

Këtë të gjetur AK ka qenë deshtë ta bëjë gjatë Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të Tenderëve, konform nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes pasi për Cilindër 2.7 ton ka ofruar dud doganor në të Cilin pesha e cilindrit është e shënuar me dorë, me laps. PSH pas shqyrtimit të këtij Pretendimi ankimor, konstaton se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, PSH konstaton se pavarësisht shkeljeve të dispozitave të LPP, të cilat i ka bërë AK, kthimi i aktivitetit të prokurimit në ri-vlerësim nuk është në dobi të asnjërës palë, përveç prolongimit të procesit të këtij aktiviteti të prokurimit.

*- Përfundim -*

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për këto veprime PSH i bënë me dije zyrtarit përgjegjës të prokurimit që në të ardhmen nëse konstatohen shkelje të ngjashme të dispozitave të LPP, do të ndërmerr të gjitha masat duke ju drejtuar KRPP me kërkesë për revokim të certifikatës profesionale të prokurimit.

PSH vendosi që të lejoj kthimin e tarifës së ankesës, për shkak se rrjedha e shqyrtimit të kësaj lënde ka pësuar ndryshime nga ajo për të cilën OE ka parashtruar ankesë.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna e Klinës
- 1x1 OE "Gurëbardhi" sh.p.k, me seli në Klinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryetari i Panelit Shqyrtues



Vedat POTERQOI